

## **Intervistë - Dardan Sejdiu, Drejtor i Përgjithshëm i Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve**

**KosovaNews: Z. Sejdiu, së fundi jemi përballë me krizën ekonomike globale, e cila ka ndikuar tek bankat, kompanitë dhe institucionet e ndryshme financiare ndërkombëtare, që kanë pësuar humbje. Si e ka kaluar Fondi Slloveno-Kosovarë i Pensioneve këtë situatë apo krizë?**

**Sejdiu:** Më lejo të them se Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve qysh në fillim ka qenë shumë konservativ sa i përket investimeve dhe kjo ka lehtësuar në masë të konsiderueshme ndikimin që kjo krizë ekonomike globale do mund të kishte. Ajo që mund të them është se ndoshta e vetmja telashe ka qenë që nuk kemi arrit rezultatet që kemi planifikuar. Por, kthimi në investime për vitin e kaluar ka qenë 11.8%, ndërsa tani kthimi për dy vitet e fundit është 11.4%, pra kemi një rënie të vlerës së njësisë por nuk kemi humbje dhe kjo është ideja. Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve shumicën e investimeve në mars i ka rishikuar edhe njëherë, duke parë që jemi në një krizë financiare, parimisht kemi ikur nga investimet të cilat ne i kemi konsideruar si të rrezikshme.

Fondi është pjesë e një grupi të madh slloven që quhet "Prva Group" grupacion ky që ka 7 kompani në rajon dhe i gjithë grupi kemi funksionuar kështu. Madje në Maqedoni jemi trust, kompani obligative që operojmë në shtyllën e dytë dhe kemi qenë shumë të suksesshëm.

**KosovaNews: A ka pasur Fondi aksione të investuara në ndonjë kompani apo institucion tjetër financiar, goftë në Kosovë apo jashtë Kosovës, dhe nga ku ka pësuar humbje në vlerën e aksioneve?**

**Sejdiu:** Ne për momentin nuk kemi mjete të investuara me aksione dhe atëherë kur kemi pasur në asnjë moment nuk e kemi kaluar 5% e mjeteve tona në tërësi. Të gjitha investimet tona janë në depozita bankare në Kosovë, obligacione shtetërore dhe në obligacione të korporatave, dhe realisht jemi në instrumentet financiare që konsiderohen më të sigurt.

**KosovaNews: Siç e dimë, Trusti Pensional i Kosovës ka pasur disa dhjetëra milion euro humbje në aksionet e investuara jashtë Kosovës, ju, si e keni përjetuar këtë situatë, dhe a ka Fondi juaj aksione në ndonjë institucion vendorë apo ndërkombëtar të investuar?**

**Sejdiu:** Krizat financiare nuk sjellin përfitues e aq më pak në Kosovë dhe ne jemi si fond vullnetar ku njerëzit me vetëdëshirë vendosin, se a të kursejnë apo jo. Nëse në media flasim më shumë për kursimet pensionale, atëherë edhe njerëzit janë më skeptikë për të kursyer.

Ne kemi qenë të suksesshëm në pjesën e parë të vitit, në aspektin e fondeve. Ndërsa në pjesën e dytë të vitit ka pas efekte kjo krizë, ku klientët kanë qenë më konservativë në përzgjedhje, por ne kemi arrit që ato rezultate që i kemi menduar edhe t'i realizojmë. Mund të themi se viti 2008, në aspekte të punës, ka qenë një vit i mirë.

**KosovaNews: Çka ofron Fondi Slloveno-Kosovarë i Pensioneve si përparësi për qytetarët e Kosovës, dhe a ka interesim nga ana e qytetarëve për të qenë pjesë e juaja?**

**Sejdiu:** Shtylla e parë është ajo që paguan shteti obligimet e pensioneve ekzistues. Shtylla e dytë është obligative, në të cilën operon Trusti i vetëm dhe njëra prej telasheve është se në vendet tjera ka konkurrencë dhe qytetari duhet patjetër të ketë zgjedhje se ku dëshiron të kursejë. Ne në Kosovë nuk e kemi atë zgjedhje. Të ne Trusti operon tash 7 vite i vetëm dhe mendoj që një qytetari duhet t'i jepet një zgjedhje.

Çka ne ofrojmë është një kursim pensional vullnetar i cili është konkurrent dhe është në përputhshmëri me dispozitat ligjore dhe është shumë transparent me klientin, ku çdo cent i investuar është transparent për klientin tonë dhe fondi jep beneficione të shumta për ata që kanë investime pensionale. Ato mjete janë kursime pensionale dhe nuk shfrytëzohen për pensionistët ekzistues, por se ato mjete ndahen vetëm për atë person që ka kontribuar në fond dhe ato mjete mund t'i shfrytëzosh pas moshës 65 vjeçare, që është një sistem i vetëfinancimit.

## **KosovaNews: Cilat janë sukseset e Fondit të arritura deri më tani?**

**Sejdiu:** Mendoj se mund të jemi një pikë krahasuese për sistemin pensional dhe mendoj që FONDI ka sjell një eksperiencë të mirë për Kosovën. Ne kemi arritur t'i paguajmë 600 pensione çdo muaj në mënyrë shumë të precize, pension ky që çdo muaj ka rritje. Suksesi tjetër është që ne kemi arritur të kemi afër 100 kompani në Kosovë që paguajnë kontribute për punëtorët e tyre. Kemi arritur të kemi një kompani shumë stabile, të kemi fonde të mira në investim dhe të kemi një rritje graduale vit për vit.

## **KosovaNews: Sa është përqindja e qytetarëve të Kosovës që janë pjesë e Fondit?**

**Sejdiu:** Kjo është zgjedhje vullnetar. Duke pasur parasysh të hyrat që kanë qytetarët kosovar nuk mund të pretendojmë të kemi përqindjen që ka sllovenia, p.sh 50%. Por, për të patur një pension të mirë personi nuk ka nevojë të kontribuojë një shumë të madhe të mjeteve, mjafton të jeni i rregullt dhe të kontribuoni 20 euro në muaj kontribut ky që për moshat e reja p.sh 30 vjeçare mund të ketë një pension shumë të mirë.

## **KosovaNews: Cilat janë sigurimet që bëni ju, apo, cila është ajo pjesë e qytetarëve që janë klientë të Fondit tuaj?**

**Sejdiu:** Secili qytetar mbi moshën 18 vjeçare me vullnet për të kursyer është i mirëseardhur në FOND. 70% të popullatës në Kosovës janë nën moshën 30 vjeçare dhe para tyre kanë periudhë të gjatë kohore për të kursyer. Shteti ndihmon kursimin me lehtësira tatimore dhe krijon mundësi shumë të mirë për kursim. Ideja është për kursim pensional dhe kështu funksionon jo vetëm në Kosovë, por në shumicën e vendeve Evropiane dhe mund të them se andej po shkojmë edhe në drejt një sistemi të qëndrueshëm.

## **KosovaNews: A keni ndonjë bashkëpunim me ndonjë fond apo institucion tjetër, qoftë brenda Kosovës apo jashtë saj?**

**Sejdiu:** Ne jemi pjesë e Prva Group, grupacion ky me bazë në Slloveni të cilët janë aksionarët tanë kryesor dhe me aksionarë tjerë korporata "Dukagjini". Ne kemi bashkëpunim me shtatë fonde të rajonit, të cilat janë kompani simotra dhe së bashku funksionojmë shumë mirë. Marrim pjesën teknike dhe mbështetjen prej kompanive të sigurta dhe prej aksionarëve, ku kemi një bashkëpunim shumë të ngushtë me kompanitë e rajonit.

## **KosovaNews: Çfarë janë objektivat e Fondit Slloveno-Kosovarë të Pensioneve për vitin 2009?**

**Sejdiu:** Synimi ynë për vitin 2009 është që të hapim tregun e Kosovës, që Trusti të ketë konkurrencë dhe që qytetarët e Kosovës të kenë mundësi të zgjedhin se ku t'i bëjnë kursimet e veta pensionale dhe ky është objektivi kryesor për vitin 2009. Mendoj që ka ardhur koha që Trusti të kenë një konkurrencë dhe atëherë mund të krahasojmë, se kush është i suksesshëm: Fondi ose Trusti. Kështu që tregu duhet të jetë i hapur dhe rregullatori është banka qendrore për të monitoruar. Këtu do të përfitoj klienti, i cili kërkon shërbimin më të mirë dhe puna me e mirë do ta fitoj klientin dhe ky është synimi ynë për këtë vit.

Intervistoi  
RINA AJETI